

DREJTORIA RAJONALE E OSSH SH.A GJIROKASTËR

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data: 10.11.2025

Drejtuar: Operatorit Ekonomik HTM sh.p.k me NUIS K97006004D, adresë: Lagjja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44, Shkodër.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat: A.L-ASFALT sh.p.k, me NUIS K81511508A, me adresë: Durrës, Xhafzotaj SALLMONE Rruga Hoxhëve, Zona kadastrale 3852, Nr pasurie 19/36 .

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-62042-09-19-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i kabinave dhe rrjetit TU me ABC në fiderin e Kardhiqit (në fshatrat Zhulat, Çepunë, Taroninë, Fushë Bardhë, Golem, Kolonjë, Mendar, Prongji, Labovë, Andon Poç, Tërbuq, Hundë Kuq)”, me fond limit 69,982,066.54 *(gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH*, me afat realizimi 10 muaj nga dorëzimi i sheshit.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 22/09/2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. TEA-D me NUIS K32522629L

Vlera: 53,759,102.78 (pesëdhjetë e tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dy pikë shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

2. L.T.E CONSTRUCTION me NUIS: L78006801F

Vlera: 62,221,487.90 (gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e njëzet e një mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO X JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat: VARAKU E sh.p.k, me NUIS J61902509S, me adresë: Qarku Durrës, Bashkia Shijak,Njësia Administrative Shijak Fshati Sallmone, Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30.

3. HTM sh.p.k me NUIS K97006004D

Vlera: 67,883,842.52 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzet e dy pikë pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO X JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat: A.L-ASFALT sh.p.k, me NUIS K81511508A, me adresë: Durrës, Xhafzotaj SALLMONE Rruga Hoxhëve, Zona kadastrale 3852, Nr pasurie 19/36.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. TEA-D me NUIS K32522629L

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Për arsyet e mëposhtme:

I. Ofertuesi duhet të përcaktojë, me anë të një deklarate të lëshuar nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarohet se: a)nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, dhe b) do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Kjo deklaratë duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbështetës si më poshtë:

- i. Librezën e punës (përkatëse);
- ii. CV-në përkatëse;
- iii. Kontratën e punës të vlefshme (përkatëse).

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se: Është paraqitur deklarata e administratorit të shoqërisë për përcaktimin e drejtuesit teknik të punimeve por mungojnë dokumentet shoqëruese të kërkuara, konkretisht librezja e punës, CV-ja dhe kontrata e punës e vlefshme për drejtuesin teknik.

Në mungesë të këtyre dokumenteve, operatori ekonomik nuk ka provuar në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme kapacitetin teknik dhe profesional që lidhet me drejtuesin teknik të punimeve, sipas kërkesave të DST.

II. Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 21 (njëzet e një) punonjës elektrikistë, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, me kontrata pune të vlefshme dhe dëshmi profesionale përkatëse, ku minimalisht 5 (pesë) prej tyre duhet të jenë të pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit Teknik (të vlefshme). Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se: OE ka paraqitur deklaratën për personelin teknik, në të cilën janë

listuar 20 punonjës elektrikistë. Në këtë mënyrë, nuk përmbushet pika 2.3.8 e DST , që lidhet me zotërimin e personelit minimal të kërkuar për kryerjen e punimeve (21 elektrikist).

III. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, u konstatua se katalogët dhe/ose specifikimet teknike të produkteve të ofruara janë dorëzuar në gjuhë të huaj pa përkthim në gjuhën shqipe. Sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, operatori ekonomik është i detyruar të paraqesë katalogë ose fragmente të katalogëve të prodhuesit për produktet e ofruara, ku të dhënat teknike bazë të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të mundësohet një vlerësim i saktë dhe transparent i përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Mosrespektimi i kësaj kërkesë përbën mospërmbushje të një kriteri teknik të domosdoshëm dhe, si i tillë, sjell si pasojë skualifikimin e operatorit ekonomik nga procedura e prokurimit

2. L.T.E CONSTRUCTION me NUIS: L78006801F

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat: VARAKU E sh.p.k, me NUIS J61902509S, me adresë: Qarku Durrës, Bashkia Shijak, Njësia Administrative Shijak Fshati Sallmone, Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30.

Për arsyet e mëposhtme:

I. Sipas pikës 2.3.1 të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, duke plotësuar njërin prej kushteve të mëposhtme: a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se: OE ka paraqitur tre kontrata të ngjashme, të cilat kanë një vlerë totale prej 129,115,585 lekë; Ndërkohë, sipas kërkesës së përcaktuar në pikën (b) më sipër, vlera e kërkuar minimale duhet të jetë jo më e vogël se 139,964,133.08 lekë. Për rrjedhojë, vlera e kontratave të paraqitura është më e ulët se vlera e kërkuar dhe nuk përmbush pikën 2.3.1 të DST.

II. Sipas pikës 2.3.3 të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), për certifikatën e cilësisë së prodhuesit ISO 9001, në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë vetëdeklarim që furnizuesi/prodhuesi është konform standardeve të cilësisë. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vetëdeklarimin gjatë procesit të vlerësimit, si dhe në rast se operatori kualifikohet i pari, të kërkojë certifikatën e cilësisë ISO 9001 të prodhuesit.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se: **Operatori nuk ka paraqitur vetëdeklarimin** që vërteton se furnizuesi/prodhuesi është konform standardeve të cilësisë ISO 9001, siç kërkohet në DST;

III. Sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), kandidati ofertues duhet të përcaktojë, me anë të një deklarate të lëshuar nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarohet se: a) nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, dhe b) do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Kjo deklaratë duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbështetës si më poshtë:

- i. Librezën e punës (përkatëse);
- ii. CV-në përkatëse;
- iii. Kontratën e punës të vlefshme (përkatëse).

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se: Është paraqitur deklarata e administratorit të shoqërisë për përcaktimin e drejtuesit teknik të punimeve por mungojnë dokumentet shoqëruese të kërkuara, konkretisht librezja e punës, CV-ja dhe kontrata e punës e vlefshme për drejtuesin teknik.

IV. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, u konstatua se katalogët dhe/ose specifikimet teknike të produkteve të ofruara janë dorëzuar në gjuhë të huaj pa përkthim në gjuhën shqipe. Sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, operatori ekonomik është i detyruar të paraqesë katalogë ose fragmente të katalogëve të prodhuesit për produktet e ofruara, ku të dhënat teknike bazë të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të mundësohet një vlerësim i saktë dhe transparent i përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Mosrespektimi i kësaj kërkesë përbën mospërmbushje të një kriteri teknik të domosdoshëm dhe, si i tillë, sjell si pasojë skualifikimin e operatorit ekonomik nga procedura e prokurimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë HTM sh.p.k, me adresë: *Lagjja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44, Shkodër*, me subjekt mbështetës shoqërinë A.L-ASFALT sh.p.k, me NUIS K81511508A, me adresë: *Durrës, Xhafzotaj SALLMONE Rruga Hoxhëve, Zona kadastrale 3852, Nr pasurie 19/36*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 67,883,842.52 (*gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzet e dy pikë pesëdhjetë e dy*) lekë pa TVSH/ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.